



Periodik mujor Nr. 184 Shtator 2024

**Në
këtë
periodik
në të lexoni:**

**Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive
e AMF-së, pjesë e panelit rajonal
në konferencën ndërkombëtare
për tregjet financiare**

Tregu i sigurimeve, janar - gusht 2024

20 24 VËSHTRIM MBI TREGJET

ZHVILLIME TË TJERA

BOTIME PROFESIONALE

6-11

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

12-14

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, pjesë e panelit rajonal në konferencën ndërkombëtare për tregjet financiare



Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi, mori pjesë në panelin rajonal për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, në konferencën ndërkombëtare me fokus tregjet financiare, zhvilluar më 24-25 shtator 2024 në Podgoricë. Ky event mbledhi së bashku, politikëbërës, përfaqësues të nivelit të lartë të autoriteteve rregullatore dhe tregjeve financiare nga rajoni e më gjerë, si dhe ekspertë të industrisë financiare, për të diskutuar mbi trendet aktuale, sfidat dhe mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre tregjeve. Znj. Kaçi dhe drejtuesit e autoriteteve homologe të vendeve të rajonit, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Kroacia diskutuan mbi zhvillimet e ardhshme të tregjeve të kapitalit në rajon.

Znj. Kaçi nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm të tregjeve të kapitalit, gjë që i shërben nxitjes së likuiditetit dhe investimeve të huaja në rajon.

Znj. Kaçi ndau me audiencën progresin dhe transformimin e tregjeve financiare në Shqipëri dhe theksoi veçanërisht rolin e Autoritetit në forcimin e kuadrit ligjor dhe rregullator si dhe iniciativat e ndërmarra në zbatim të dokumentit të politikave për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, miratuar nga Qeveria Shqiptare vitin e kaluar. Gjithashtu ajo nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm të tregjeve të kapitalit, gjë që i shërben nxitjes së likuiditetit dhe investimeve të huaja në rajon.

Konferenca, organizuar nga Autoriteti i Tregut të Kapitaleve të Malit të Zi, në bashkëpunim me Bankën Qendrore, Ministrinë e Financave dhe Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi, shërbeu si një platformë për dialog dhe bashkëpunim rajonal në drejtim të integritetit dhe forcimit të tregjeve financiare në Ballkanin Perëndimor.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar – gusht 2024


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-gusht 2024 kapën vlerën 16,349 milionë lekë, ose 6.64% më shumë se në janar-gusht 2023. Gjatë periudhës janar-gusht 2024, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,051,878 me një rritje prej 8.32% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.85% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.11% dhe risigurimi me 0.036%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.93% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.07% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-gusht 2024, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 5,595 milionë lekë, ose 29.04% më shumë se në periudhën janar-gusht 2023.


Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-gusht 2024 kapën vlerën 4,089 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 29.83% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar – gusht 2024 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-gusht 2024 arritën rreth 9,820 milionë lekë, ose 8.28 % më shumë se në periudhën janar-gusht 2023.

AMF publikon “Gjeografia e Sigurimeve 2023”



Gjeografia e Sigurimeve 2023, pasqyron në mënyrë të detajuar shpërndarjen e primeve të shkruara bruto, dëmeve të paguara si edhe primit për frymë, sipas prefekturave.

Duke analizuar shpërndarjen gjeografike të primit të shkruar bruto, vërehet një përqendrim i tregut të sigurimeve në prefekturat e mëdha, si Tirana me 62.58% të totalit të primeve të shkruara bruto gjatë vitit 2023, Durrësi me 7.29%, Fieri 4.50%, Elbasani 4.15% dhe Korça 4.94%. Kjo tendencë përqendrimi ka vijuar e tillë për një periudhë 15-vjeçare.

Një tregues tjetër i rëndësishëm i tregut të sigurimeve është dendësia e sigurimeve. Për vitin 2023 ky tregues është rreth 9,526.16 lekë për frymë, me një rritje rreth 1,928.16 lekë krahasuar me një vit më parë.

Përsa i përket primit për frymë sipas prefekturave, prefektura Tiranë me 18,878.40 lekë për frymë zë vendin e parë, e pasuar nga prefektura Gjirokastër me 6,956.64 lekë për frymë dhe më tej Durrësi me 7,354.26 lekë për frymë, Vlora me 7,059.67 lekë për frymë dhe Korçë me 6,527.69 lekë për frymë.

Ky publikim përfshin gjithashtu edhe informacion të hollësishëm për dëmet e paguara gjatë vitit 2023 sipas prefekturave, duke krijuar edhe mundësinë e krahasimit të këtyre treguesve me ato të një viti më parë. Përsëri pjesën më të madhe të dëmeve të paguara e ka prefektura e Tiranës me 70.84%, e pasuar nga prefektura Durrësi me 7.04%

Gjeografia e sigurimeve përfshin informacion të hollësishëm për dëmet e paguara gjatë vitit 2023 sipas prefekturave, duke krijuar edhe mundësinë e krahasimit të këtyre treguesve me ato të një viti më parë.

ZHVILLIME TË TJERA

Vizitë zyrtare e Drejtoreshës së Përgjithshme Ekzekutive të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Bankën Intesa Sanpaolo, Itali



Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Mimoza Kaçi, zhvilloi një vizitë zyrtare në Itali, gjatë së cilës u takua me drejtues të lartë të grupit Intesa Sanpaolo. Gjatë takimeve, Znj. Kaçi u prit nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve të Grupit Intesa Sanpaolo, Z. Gian Maria Gros-Pietro, si dhe drejtues të lartë të Divizionit Ndërkombëtar të Bankave të Huaja dhe të Eurizon SRG.

Diskutimet u përqendruan në mundësitë e bashkëpunimit në nisma të edukimit financiar dhe në tendencat aktuale të tregjeve dhe mundësitë e aplikimit të inovacionit dhe teknologjisë në fushën financiare. Vizita në Muzeun e Kursimeve të Bankës Intesa Sanpaolo ofroi një perspektivë të rëndësishme mbi historinë dhe rëndësinë e edukimit financiar, një fushë me prioritet për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Duke vlerësuar prezencën e kapitalit italian në tregun financiar shqiptar, zonja Kaçi theksoi se kjo vizitë ishte produktive dhe na ofroi mundësi të shumë të mira për të forcuar marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë. Eksperienca e grupit Intesa Sanpaolo përbën një vlerë të shtuar në avancimin cilësor të punës sonë për edukimin financiar".

Kjo vizitë është një hap i rëndësishëm në angazhimin e Autoritetit për të sjellë praktikatat më të mira evropiane në tregun financiar shqiptar.

Diskutimet u përqendruan në mundësitë e bashkëpunimit në nisma të edukimit financiar dhe në tendencat aktuale të tregjeve dhe mundësitë e aplikimit të inovacionit dhe teknologjisë në fushën financiare.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mbështet edukimin financiar përmes lojës në bursën virtuale të titujve, *Stock Market Learning Competition*



Konkursi ofron një platformë virtuale tregtimi në bursë ku pjesëmarrësit përdorin fonde virtuale për të tregtuar tituj të ndryshëm, duke fituar njohuri praktike mbi funksionimin e tregjeve financiare.

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi, mori pjesë në aktivitetin hapës të lojës në bursën virtuale të titujve "Stock Market Learning Competition". Ky është viti i katër qv Autoriteti mbështet këtë projekt të nisur me iniciativën e Fondacionit Gjerman Sparkassen për Bashkëpunim Ndërkombëtar, (DSIK Albania).

Në fjalën e saj, znj. Kaçi theksoi: "Edukimi financiar mbetet një nga prioritetet tona, në përputhje me Strategjinë e Autoritetit për Edukim dhe Përfshirje Financiare 2023-2027. Ky projekt u ofron të rinjve mundësinë të mendojnë në mënyrë kritike, të veprojnë strategjikisht dhe të fitojnë një kuptueshmëri më të thellë të dinamikave në tregjet financiare." Znj. Kaçi vuri në dukje angazhimin e Autoritetit për të rritur njohuritë financiare të publikut, për të forcuar besimin në institucionet financiare dhe për t'i pajisur qytetarët me informacionin e nevojshëm për vendimmarrje financiare të shëndosha.

Konkursi, bazuar në metodologjinë *learning by doing*, ofron një platformë virtuale tregtimi në bursë ku pjesëmarrësit përdorin fonde virtuale për të tregtuar tituj të ndryshëm, duke fituar njohuri praktike mbi funksionimin e tregjeve financiare. Edicioni i këtij viti vjen me zgjerimin e pjesëmarrjes ndërkombëtare me studentë nga universitete të rajonit, si dhe përfshirjen e skuadrave nga bankat tregtare vendase.

AMF tryezë diskutimi për Kapitullin 9-të “Shërbimet Financiare” në kuadër të integritimit evropian




Znj. Kaçi nënvizoi se “Vendosja e rregullave dhe standarteve evropiane i përgjigjet dinamikës dhe trajektores së zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Qëllimi ynë është të krijojmë një mjedis transparent dhe eficient që minimizon rreziqet dhe promovon stabilitet e qëndrueshmëri”.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), organizuan tryezë diskutimi me temë "Përafrimi i legjislacionit shqiptar me Direktivat e BE-së për mbikëqyrjen e konglomerateve financiare dhe skemën e kompensimit të investitorit". Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bankës së Shqipërisë, Agjensisë së Sigurimit të Depozitave, institucioneve financiare, si dhe ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë në fushën e shërbimeve financiare.

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit, znj. Mimoza Kaçi, theksoi rëndësinë e këtij aktiviteti si një hap i rëndësishëm drejt përbushjes së angazhimeve në kuadër të Kapitullit 9 “Shërbimet financiare”, lidhur me harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me Acquis të BE-së.

Gjatë aktivitetit u lançua projekti “Për Skemën e Kompensimit të Investitorëve”, si dhe u prezantua dokumenti teknik mbi harmonizimin e legjislacionit vendas me Direktivën e BE-së për mbikëqyrjen e Konglomerateve Financiare. Znj. Kaçi nënvizoi se “Vendosja e rregullave dhe standarteve evropiane i përgjigjet dinamikës dhe trajektores së zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Qëllimi ynë është të krijojmë një mjedis transparent dhe eficient që minimizon rreziqet dhe promovon stabilitet e qëndrueshmëri”. Në përfundim të takimit, znj. Kaçi shprehu angazhimin e Autoritetit për të kontribuar në avancimin e modernizimit të tregjeve financiare në vend dhe forcimit të mbrojtjes së investitorëve dhe konsumatorëve.

Autoriteti nxjerr për konsultim publik projektregulloren “Për procedurën, dokumentacionin, kushtet dhe mënyrën e zbatimit të ndryshimeve të formës së fondit të pensionit privat”.



Faqe Kryesore ▶ Legjislati ▶ Projektakte ▶

Projektregullore “Për procedurën, dokumentacionin, kushtet dhe mënyrën e zbatimit të ndryshimeve të formës së fondit të pensi

Projektregullore “Për procedurën, dokumentacionin, kushtet dhe mënyrën e zbatimit të ndryshimeve të formës së fondit të pensionit privat”

 Materiali i plotë

[Projektregullore “Për procedurën, dokumentacionin, kushtet dhe mënyrën e zbatimit të ndryshimeve të formës së fondit të pensionit privat”](#)

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, ka hartuar projektregulloren: “Për procedurën, dokumentacionin, kushtet dhe mënyrën e zbatimit të ndryshimeve të formës së fondit të pensionit privat”.

Projektregullorja e sipërpërmendur publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=110>

Autoriteti nxjerr për konsultim publik projektregulloren “Për regjistrin e pronësisë së fondit të pensionit privat dhe vërtetimin për gjendjen e llogarisë së anëtarit në fondin e pensionit”



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, ka hartuar projektregulloren: “Për regjistrin e pronësisë së fondit të pensionit privat dhe vërtetimin për gjendjen e llogarisë së anëtarit në fondin e pensionit”.

Projektregullorja e sipërpërmendur publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=111>

<https://amf.gov.al/pdf/fokus/Rregulloreperregjistrinepronesisesefondittepensionitprivatdhevertetiminegjenjesselllogarise.pdf>



IAIS publikon materiale mbështetëse në funksion të mbikëqyrjes në sigurime

<https://www.iaisweb.org/consultations/>

IAIS pranon se konsultimi efektiv mund të sjellë informacion të vlefshëm për të ndihmuar në hartimin e zgjidhjeve të suksesshme të politikave dhe marrjen e vendimeve të informuara. I gjithë materiali mbikëqyrës dhe mbështetës i nënshtrohet konsultimit publik.

Materialet për Aplikim “Application Papers” ofrojnë informacione mbështetëse lidhur me materiale të veçanta mbikëqyrëse siç mund të jenë Parimet Bazë të Sigurimeve apo Kuadri i Përbashkët (ICP ose ComFrame). Materialet për Aplikim mund të jepen në rrethana kur zbatimi praktik i parimeve dhe standardeve mund të ndryshojë ose kur interpretimi dhe zbatimi i tyre mund të paraqesë sfida. Materialet për Aplikim nuk përfshijnë kërkesa të reja, por ofrojnë këshilla të mëtejshme, ilustrime, rekomandime ose shembuj të praktikës së mirë për mbikëqyrësit se si mund të zbatohet materiali mbikëqyrës. Parimi i proporcionalitetit zbatohet për përmbajtjen e Materialeve për Aplikim.

- Draft Material Aplikimi (*Application Paper*) për objektivat dhe paketën e mjeteve të rezistencës operacionale;
[Draft Application Paper on Operational Resilience Objectives and Toolkit;](#)
- Draft Material Aplikimi (*Application Paper*) për prezantimin publik dhe raportimin mbikëqyrës të rrezikut klimatik;
[Draft Application Paper on public disclosure and supervisory reporting of climate risk;](#)
- Draft i materialeve mbështetëse për çështjet makroprudenciale dhe mbikëqyrëse të grupit dhe rrezikun e klimës;
[Draft supporting material on macroprudential and group supervisory issues and climate risk;](#)
- Pyetje për konsultim publik mbi Draft Material Aplikimi (*Application Paper*) se si të arrihet trajtim i drejtë për konsumatorë të ndryshëm
[Questions for public consultation on draft Application Paper on how to achieve fair treatment for diverse consumers;](#)
- Draft Material Aplikimi (*Application Paper*) se si të arrihet trajtim i drejtë për konsultime të ndryshme me konsumatorë
[Draft Application Paper on how to achieve fair treatment for diverse consumers consultation.](#)

ÇEKI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Bankës Kombëtare Çeke, siguruesit çekë përfunduan tremujorin e parë 2024 me vlerën e primeve të shkruara bruto rreth 2.35 miliardë euro, pothuajse e barabartë me atë të tremujorit të parë 2023. Dëmtimet e paguara janë ulur me 1.6%, duke arritur në 1.07 miliardë euro.

Sektori i sigurimeve të Jetës ishte ai që influenoi negativisht dinamikën e përgjithshme, pasi primet e shkruara bruto u ulën me 4.4%, duke arritur në 577.5 milionë euro. Në segmentin e sigurimeve të Jo-Jetës, vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit me 1.9%, duke arritur në 1.77 miliardë euro. Pjesa më e madhe e kësaj shume u sigurua nga linjat e sigurimit motorik, për të cilat primet arritën në 745.26 milionë euro. Sigurimi i pronës është segmenti i dytë më i madh i sigurimit të Jo-Jetës, me vlerë të primeve 439.97 milionë euro, dhe që shënoi një rritje prej 3% në terma vjetore.

Dëmet e paguara për sigurimet e Jo-Jetës u rritën me ritëm më të lartë, prej 4.2%, duke arritur në 734.8 milionë euro. Megjithatë, ndërsa dëmet për sigurime motorike zënë peshën më të madhe në këtë total, ato mbetën pothuajse të pandryshuara krahasuar me vitin e kaluar. Në të njëjtën kohë, pretendimet për sigurime pronësore u rritën me gati 19%, duke arritur në 126 milionë euro.

KOSOVA

www.xprimm.com

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për shoqëritë e sigurimit në Kosovë arriti në vlerën e 82 milionë euro në gjysmën e parë të vitit 2024, duke shënuar një rritje prej 16.78% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Dëmet e paguara arritën në 35 milionë euro, duke u ulur me 3.3% në terma vjetorë.

Sigurimi i Jetës ka ende një prani mjaft të ulët në portofolin e tregut, ndërsa sigurimet e Jo-Jetës përbëjnë mbi 95% të vëllimit të primeve të shkruara bruto. Nga totali primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës, më shumë se gjysma vjen nga linja e sigurimit motorik MTPL, rreth 52%.

Shifrat tregojnë se rezultati agregat tremujor i tregut ishte pozitiv, 12 siguruesit vendas (nga të cilët shtatë janë me pronësi të huaj) raportuan një fitim neto prej 10.5 milionë euro. Në të njëjtën kohë, vlera totale e aseteve të zotëruara nga kompanitë e sigurimeve kosovare u rrit, duke arritur në 330 milionë euro në fund të gjashtëmujorit të parë 2024.

HUNGARI

www.xprimm.com

Të dhënat e publikuara nga Banka Qendrore e Hungarisë, MNB, tregojnë se tregu hungarez i sigurimeve pati një rritje prej rreth 5% në terma vjetorë të vëllimit të primeve të shkruara bruto, duke arritur në 2.2 miliardë euro. Megjithatë, të shprehura në monedhën vendase (HUF, Forintë hungareze) rezultatet e tregut tregojnë një normë më të lartë rritjeje, prej gati 12%, diferenca që reflekton nënçmimin e Forintës hungareze kundrejt euros.

Pagesat e dëmeve u rritën në përgjithësi me 2.4%, duke arritur në 1.07 miliardë euro. Megjithatë, kjo dinamikë e përgjithshme është rezultat i dy tendencave të ndryshme të vërejtura në sektorët e sigurimeve të Jetës dhe të Jo-Jetës: ndërsa në sigurimin e Jetës përfitimet dhe dëmet e paguara u ulën në përgjithësi me më shumë se 10%, në sigurimin e Jo-Jetës kishte një rritje të dyshifrore të dëmeve të paguara, prej 19%.

Sigurimet e Jetës kishin një normë modeste rritjeje prej 1.35% (në euro), e cila u ndikua nga rënia e popullaritetit të linjës së produkteve Unit-Linked, për të cilën primet u ulën me rreth 2% e shprehur në terma vjetore.

Primet e sigurimit të Jo-Jetës, që zënë 63.5% të të gjithë portofolit, arritën në 1.39 miliardë euro, me një rritje rreth 7.19% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Klasat e sigurimit motorik dhe sigurimit të pronës mbajnë së bashku rreth 54% të vëllimit të primeve të shkruara bruto për sigurimet e Jo-Jetës dhe kanë gjeneruar pothuajse 44% të vëllimit total të dëmeve të paguara. Sigurimi i detyrueshëm MTPL shënoi një normë rritjeje nën mesatare, prej 6.8%, primeve, duke arritur në 463 milionë euro.

Ndryshimi më i rëndësishëm në dëmet e paguara, prej 35.6%, u regjistrua për kategorinë e sigurimit të pronës, kryesisht nën ndikimin e ngjarjeve ekstreme të motit që kanë prekur në mënyrë të përsëritur territorin hungarez. Sipas MABISZ, dëmi mesatar i shkaktuar nga stuhitë kalon aktualisht 120,000 HUF, që është rreth 20-40% më i lartë se shumatat e disa viteve më parë.

MAQEDONIA E VERIUT

www.xprimm.com

Siguruesit në Maqedoninë e Veriut, për tremujorin e parë 2024, kanë realizuar prime të shkruara bruto me vlerë 67.5 milionë euro, e cila shpreh një rritje 18.5% më shumë, në krahasim me vitin e kaluar. Dëmet e paguara u rritën me 7.5%, duke arritur në 23.47 milionë euro.

Strukturat e portofolit të tregut mbetën pothuajse të pandryshuara, me përjashtim të dy klasave kryesore të sigurimit: pesha e sigurimit MTPL u ul me gati 4 pikë përqindjeje, ndërsa biznesi i sigurimit të pronës fitoi rreth 2.6 pikë përqindje të peshës së portofolit.

Primet e shkruara bruto për sigurimet e Jetës janë rritur me 4.5%, duke arritur në 10.6 milionë euro. Lajmi i mirë erdhi nga segmenti i sigurimit të pronës, i cili rriti me 36% vlerën e primeve të shkruara bruto, duke arritur në 13.53 milionë euro. Ndoshta mësimet e nxjerra nga prania gjithnjë në rritje e ngjarjeve ekstreme të motit kanë filluar të rrisin ndërgjegjësimin për rreziqet klimatike. Megjithatë, ekziston ende një hendek i madh në mbrojtjen ndaj fatkeqësive natyrore.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara nga Agjencia lokale e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Malin e Zi (ISA), tregu i sigurimeve në vend arriti në 68.23 milionë euro në fund të gjashtëmujorit të parë 2024. Kjo shifër paraqet një rritje prej 13.95% në terma vjetorë. Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës përfaqëson 81.35% të totalit të tregut të sigurimeve me një vlerë prej rreth 55.5 milionë euro dhe rritje prej 12% në terma vjetore. Ndërsa vëllimi i primeve të shkruara bruto e në segmentin e tregut të sigurimit të Jetës u rrit me 23.11% në vit duke arritur në 12.7 milionë euro.

Linjat e sigurimit motorik përbëjnë pothuajse 43% të vëllimit të primeve të shkruara bruto të totalit të tregut. Në përgjithësi, primet e shkruara bruto për sigurimet motorike u rritën me 11.47%, ndërsa dëmet e paguara u rritën me 24.66%.

RUMANI

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto të shoqërive të sigurimeve të vendosura në Rumani, për tremujorin e parë 2024, arritën në rreth 961.3 milionë euro, ose rreth 0.4% më shumë se një vit më parë. Ky vëllim përbën 86% të vëllimit total të primeve të shkruara bruto në Rumani. Ndërkohë, për degët e kompanive të huaja që operojnë në Rumani nën FOE, vëllimi i primeve arriti në 154.5 milionë euro.

Në total, në tremujorin e parë 2024, tregu rumun i sigurimeve (i përbërë nga kompani të autorizuara dhe të mbikëqyrura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë) kaloi 1.1 miliardë lei, duke shënuar një rritje prej 3.2% në terma vjetorë. Nga ky total, sigurimet e Jetës zënë afërsisht 20% ose 224 milionë euro, ndërsa sigurimet e Jo-Jetës zënë 79.9% të totalit të tregut, me vlerë të primeve rreth 892 milionë euro. MTPL është linja e sigurimit për të cilën kontributi i degëve të huaja është më i forti. Nga vëllimi total i primeve të shkruara bruto për MTPL prej 437 milionë euro, 72 milionë euro janë rezultat i aktivitetit të degëve të huaja.

Sipas raportit të publikuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë, tregu përfshin 25 shoqëri sigurimesh të autorizuara dhe 15 degë.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al